



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Sot në datë 05.06.2024, Autoriteti i Konkurrencës zhvilloi përpara Komisionit për Ekonominë dhe Financat të Kuvendit të Shqipërisë seancën dëgjimore mbi raportimin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2023.

Në këtë dëgjesë, Autoriteti i Konkurrencës u përfaqësua nga: z. Denar Biba, Kryetar, znj. Leida Matja, zëvendëskryetare dhe nga znj. Rezana Konomi Perolla, z. Durim Kraja, Znj. Fatjola Delija, anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.

Në fjalën e tij, Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, z. Biba prezantoi një përmbledhje të raportit vjetor mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës, duke u ndalur në arritjet më kryesore të vitit 2023, si dhe në zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Gjatë parashtrimit të fjalës së tij, z. Biba informoi Komisionin për Ekonominë dhe Financat se, gjatë vitit 2023, Komisioni i Konkurrencës ka marrë 93 vendime, kryer 15 monitorime dhe realizuar 8 procedura hetimore, në tregjet sensitive dhe me ndikim të drejtpërdrejtë për mirëqenien e konsumatorit. Gjatë vitit 2023, janë intensifikuar marrëdhëniet brenda dhe jashtë vendit me zhvillimin e 5 aktiviteteve: 1 (një) konferencë ndërkombëtare, 1 (një) takim me botën akademike në Tiranë dhe 3 (tre) workshop-e me komunitetin e biznesit. Në kuadër të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2023 - 2025, Autoriteti i Konkurrencës ka përmbushur 100% këtë plan, duke miratuar brenda afateve kohore të përcaktuara, 3 (tre) aktet nënligjore të parashikuara, në përputhje të plotë me legjislacionin evropian në fushën e konkurrencës.

Në funksionin e relatores, anëtarja e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, znj. Antoneta Dhima relatoi zbatueshmërinë e rekomandimeve të dhëna në Rezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2022”, nr. 1094/2, datë 22.06.2023 duke propozuar dhe projekt rekomandimet përkatëse për vitin 2024.

Seanca vijoi me pyetje nga anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat, të cilave z. Biba dhe anëtarët e Komisionit të Konkurrencës ju përgjigjën duke sqaruar të pranishmit rreth procedurave hetimore, tregjeve të monitoruara dhe hapave të ndërmarra nga institucioni për sigurimin e një konkurrence të lirë dhe efektive në treg

Nga ana e Kryetarit të Komisionit për Ekonominë dhe Financat z. Eduard Shalsi u shpreh vlerësim për aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës duke theksuar në të njëjtën kohë nevojën për bashkëpunim më të mirë ndër institucional.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>.